

Linku i projektit: <https://unishk.edu.al/en/scientific-research/projects/supporting-development-of-transcultural-competence-for-healthcare-professionals-in-the-western-balkans>



KICK OFF meeting “TCCWB - Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans”

Takimi i parë i projektit **T C C W B** u mbajt në Zenicë, Bosnje dhe Hercegovinë, në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Zenicës, në datat 11-12 qershor 2024. Në këtë takim morën pjesë partnerët, si vijon:

- Universiteti ODISEE, Belgjikë;
- Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës dhe Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi” Shqipëri;
- Turun Ammattikorkeakoulu, Finlandë;
- dhe partnerët nga Bosnje dhe Hercegovinë: Javna Ustanova Univerzitet U Zenici Universitas Stba, Univerzitet U Istocnom Sarajevu, Fondacija Fami - Zaklada Fami, Sarajevo Susret Kultura, Univerzitet Dzermal Bijedic U Mostaru Sa Supsidijar.

Gjatë dy ditëve të eventit, u bë një prezantim i specifikave të secilit partner në projekt, u mbajtën ligjërata mbi kompetencat kulturore në infermieri, dhe u hartua plani i punës për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara gjatë tre viteve në vijim.





Takim online organizuar nga Universiteti Turku, Finlandë në kuadër të projektit “TCCWB - Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans”

Takimi i dytë i projektit **T C C W B** “TCCWB - Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans” u mbajt online në datën 1 tetor 2024 me pjesëmarrjen e të gjithë partnerëve të projektit.


Në këtë takim u diskutua mbi:

- Përkufizimin konceptual mbi kompetencën kulturore.
- Gjetjet nga rishikimi i literaturës në lidhje me metodat e mësimdhënies/mësimnxënies të kompetencave kulturore, mjetet e matjes dhe anketat për situatën që kërkon ndërhyrje në universitetet partnere.
- Diskutim në grup dhe reflektim mbi mjetet e mundshme të vlerësimit. Marrëveshje për procesin e përkthimit të materialeve dhe mjetet online që do të përdoren.
- Përgatitje për takimin e ardhshëm.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB

TCCWB online meeting E2.2

Date: 1st October 2024
Venue: online in Teams



Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union 